



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 15/05/2025

PROCES VERBAL

Konsultimi Publik mbi Planin Afatmesëm për Arsimin Parauniversitar

Vendi : Salla e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Përmet

Ora : 13:00

Tema e konsultimit : Plani Afatmesëm për Arsimin Parauniversitar

I mbajtur sot më datë 15 Maj në ambientet e Sallës së Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Përmet me pjesëmarrjen e Nënkryetares së Bashkisë znj. Aulona Meshini, administrate e Bashkisë Përmet, Drejtues të shkollave 9-vjeçare të qytetit, Edukatore të kopshteve, përfaqësues nga ZVA dhe prindër të fëmijëve.

Takimin e hapi Nënkryetarja e Bashkisë Përmet e cila fillimisht falenderoi të gjithë të pranishmit. Ajo theksoi se është bërë një punë e gjatë për hartimin e këtij plani si dhe një ndihmesë të madhe ka dhënë projekti “Bashki të Forta”.

Më pas znj. Meshini filloi t’u prezantonte draft-planin e hartuar i cili do të sjellë një ndryshim të madh në gjithë arsimin parauniversitar. Në hyrje të tij ajo i njohu të pranishmit me grupin e punës që ka marrë pjesë në hartimin e këtij plani. Në vijim dha informacione lidhur me vështrimin gjeografik dhe historik të rrethit të Përmetit.

Duke vijuar prezantimin Nënkryetarja u tregoi për objektivat e këtij plani të cilët duhet të kompletohen pothuajse 100% për vitet në vazhdim. Më pas paraqiti një analizë të gjëndjes aktuale e cila është realizuar falë të dhënave të marra nga Bashkia Përmet në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

Në përfundim të fjalës së saj gjithashtu theksoi se edukatorët dhe mësuesit do të kenë një detyrë të rëndësishme në realizimin e këtij plani si dhe në edukimin e brezave të rinj për të bërë maksimumin e detyrës. Një falenderim të veçantë për shkollat të cilat shprehën gatishmërinë për të ndihmuar dhe për të qënë pjesë e këtij projekti. Gjithashtu u tha se ishte e hapur për të dëgjuar idetë dhe sugjerimet e të gjithë pjesëmarrësve.



Të gjithë të pranishmit ishin mjaft të kënaqur dhe entuziast nga ky plan dhe njëzëri shprehën falenderim dhe vlerësim maksimal për të gjithë aktorët e përfshirë në këtë projekt. Disa nga sugjerimet e tyre ishin :


- Të pajisen me uniforma fëmijët e kopshteve.
- Të këtë oficerë sigurie, psikologë, koordinator për këshillim karriere në çdo shkollë.
- Të zhvillohen më shumë orë mësimorë në natyrë.

Në fund të takimit përfaqësuesit e shkollave dhe kopshteve morën angazhimin për të bërë maksimumin që ky plan të gjejë sa më shume hapësira për zhvillim.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska



SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURRO

Foto nga takimi:



